



Universiteti Bujqësor i Tiranës



Shoqata e Kultivimeve të Bimeve Eterojavore,
prodhuesve dhe eksportuesve të esencave të tyre.

Nr. 2336 Prot.

Datë 10/06/2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

DHE

SHOQATES SE KULTIVIMEVE TË BIMEVE ETEROJAVORE, PRODHUESVE DHE EKSPORTUESVE TË ESENCAVE TË TYRE

Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Universitetit Bujqësor të Tiranës, e quajtur më poshtë **UBT** me adresë Rruga Pajsi Vodica Tiranë, përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Fatbardh Sallaku dhe Shoqatës së Kultivimeve të Bimëve Eterojavore, prodhuesve dhe eksportuesve të esencave të tyre, (**EPCA**), me adresë, Rruga Adem Seit Kruja nr. 38, Tiranë, përfaqësuar nga z. Xhevit Hysenaj

Palët e mësipërme bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi (më poshtë "Marrëveshja") është bashkëpunimi ndërmjet Universitetit Bujqësor të Tiranës Shoqatës së Kultivimeve të Bimëve Eterojavore, prodhuesve dhe eksportuesve të esencave të tyre, për fushat si më poshtë vijon:

- a. Përmirësimi i standardeve të cilësisë përmes shkëmbimit të njohurive midis Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe sektorit privat në sektorin e Bimëve Aromatike dhe Mjekësore (BAM)
- b. Demonstrim dhe zhvillim i metodave dhe i praktikave të mira bujqësore që kanë në fokus zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor në sektorin e BAM;
- c. Realizimi i aktiviteteve trajnuese për sektorin e BAM;
- d. Projekte të përbashkëta të testimit për futjen e varieteteve apo bimëve të reja të BAM nëpërmjet studimeve gjenetike dhe provave fushore rajonale.
- e. Projekte të përbashkëta të përmirësimit të teknologjive të kultivimit të BAM nëpërmjet provave fushore dhe rajonale.
- f. Realizim i praktikave profesionale të studentëve pranë Bizneseve të BAM;

Neni 2

Marrëveshja e bashkëpunimit do të mbështetet mbi bazën e legjislacionit në fuqi. Palët zotohen që të mirekuptojnë nevojat e përbashkëta gjatë bashkëpunimit të tyre me qëllim për të përfituar nga zhvillimi dhe shkëmbimi shkencor e profesional.

Neni 3

Bashkëpunimet e mbështetura në këtë marrëveshje do të përcaktohen me detaje në kërkesat e palëve dhe më pas do të firmosen nga përfaqësuesit e autorizuar të secilës palë.

Neni 4

Kjo marrëveshje bashkëpunimi nënshkruhet në 2 kopje në gjuhën shqipe. Kjo marrëveshje bashkëpunimi nënshkruhet për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh. Në rast se asnjëra nga palët nuk shpreh vullnetin për t'i dhënë fund, marrëveshja ripërtërihet edhe për një periudhë tjetër 3 (tre) vjeçare.

Në çdo rast, secila nga palët nënshkruese mund t'i japë fund marrëveshjes duke shprehur vullnetin e saj me shkrim, të paktën 3(tre) muaj më parë.

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve do të zgjidhet me mirëkuptim dhe bisedime.

Neni 5

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e firmosjes nga përfaqësuesit e palëve pjesëmarrëse në marrëveshje.

Për Universitetin Bujqësor të Tiranës

Rektori
Prof. Dr. Fatbardh Sallaku



Shoqata e Kultivimeve të bimeve
Eterojavore, prodhuesve dhe
eksportuesve të esencave të tyre

Kryetar
Xhevit Hysenaj

Xhevit Hysenaj